

**FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS**  
**FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA**  
**FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVA**

---

---



**RREGULLORE**

**mbi regjistrimin, statusin dhe transferin e lojtarëve**

---

Prishtinë, Korrik 2019

## PËRMBAJTJA

### **Faqe Neni**

<b>4</b>	<b>I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b>
<b>4</b>	<b>II. REGJISTRIMI I KLUBEVE</b>
<b>5</b>	<b>III. REGJISTRIMI I LOJTARËVE</b>
7	Organi për regjistrimin e lojtarit
7	Komisioni për regjistrimin dhe statusin e lojtarëve (KRSL)
7	Dokumentacioni për regjistrimin e lojtarëve
9	Kërkesa për regjistrim
10	Libreza sportive
10	Çregjistrimi
10	Shlyerja nga anëtarësia
11	Pasaporti i lojtarit
<b>11</b>	<b>IV. NDËRRIMI I KLUBIT</b>
11	E drejta e ndërrimit të klubit
12	Procedura për ndërrimin e klubit gjatë afatit kalimtar
12	Regjistrimi pa fletëlëshim dhe pa fletëçregjistrim
12	Kushtet e veçanta për lojtarët e rinj, kadetët dhe pionierët
13	Heqja dorë nga ndërrimi i klubit
<b>13</b>	<b>V. PERIUDHAT E REGJISTRIMIT</b>
14	Publikimi i regjistrimit
<b>14</b>	<b>VI. FITIMI I SË DREJTËS PËR PARAQITJE</b>
16	Regjistri i lojtarëve profesionist
16	Afatet
16	Huazimi i lojtarit profesional
17	Regjistrimi i lojtarëve shtetas të huaj, lojtarëve me shtetësi të dyfishtë dhe shtetasve tonë që vijnë nga klubet e jashtme
17	Çertifikata ndërkombëtare e transferit (ITC)
19	Mbrojtja e lojtarëve të mitur
20	Regjistrimi dhe raportimi i të miturve në akademi
21	Vërtetimi i regjistrimit të lojtarit, kundërshtimi dhe ankesa

21	Kundërshtimi
22	Ankesa
23	Kundërvajtjet gjatë regjistrimit të lojtarëve
23	Paraqitja e lojtarëve për Përfaqësuesen
<b>24</b>	<b>VII. STATUSI I LOJTARËVE</b>
24	Lojtari amator
24	Riamaterizimi
25	Ndalimi i aktivitetit
25	Lojtari profesionist
25	Lidhja e kontratës profesionale
<b>27</b>	<b>VIII. MBAJTJA E STABILITETIT KONTRAKTUES NDËRMJET LOJTARIT DHE KLUBIT</b>
27	Respektimi i kontratës
27	Shkëputja e kontratës për shkaqe të arsyeshme
28	Shkëputja e kontratës për shkaqe të arësyeshme sportive
28	Pasojat e shkëputjes së kontratës pa shkaqe të arësyeshme
29	Periudha e mbrojtjes
30	Dispozitat e veçanta lidhur me kontratën ndërmjet lojtarit profesionist dhe klubit
31	Kontestet lidhur me kontrata
<b>32</b>	<b>IX. KOMPENZIMI PËR TRAJNIM DHE ZHVILLIM TË LOJTARIT DHE MEKANIZMI I SOLIDARITETIT</b>
32	Kompensimi për trajnimin dhe zhvillimin e lojtarit
36	Mekanizmi i solidaritetit
<b>37</b>	<b>X. DISPOZITAT PËR FUTBOLLIN E VOGËL</b>
<b>38</b>	<b>XI. JURISDIKSIONI</b>
38	Kompetenca e FIFA-s
39	Komisioni për statusin e lojtarëve
39	Dhoma e zgjidhjes së kontesteve e FIFA-s (DHZK)
40	Dhoma Nacionale e Zgjidhjes së Kontesteve (DHNZK)
<b>40</b>	<b>XII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT</b>

Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, në bazë të nenit 33 p.3 nën a) të Statutit të FFK-së, në mbledhjen e vet të mbajtur me Korrik 2010, aprovoi këtë:

## **RREGULLORE**

### **mbi regjistrimin, statusin dhe transferin e lojtarëve**

#### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

Federata e Futbollit të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm- FFK) me këtë Rregullore do të përcaktojë mënyrën e paraqitjes dhe regjistrimit të klubeve dhe lojtarëve, statusin e lojtarëve, transferin e tyre, periudhat e regjistrimit, fitimin e të drejtës në lojë, lëshimin e certifikatës ndërkombëtare (ITC), huazimet e lojtarëve të drejtat në kompensim nga transferet, mbrojtja e minorëve, marrëdhëniet kontraktuale si dhe të gjitha çështjet e lidhura me regjistrimin dhe statusin e lojtarëve në Kosovë.

#### **II. REGJISTRIMI I KLUBEVE**

##### **Neni 2**

1. Për tu anëtarësuar një klub në FFK duhet që t'i plotësojë këto kushte:
  - a) Që organit kompetent t'i paraqesë kërkesën për regjistrim dhe deklaratën se do t'i respektojnë aktet normative dhe vendimet e FFK-së.
  - b) Të deponon vendimin e Drejtorisë Komunale për sport,
  - c) Të sjellë procesverbalin e Kuvendit të vet konstituiv me listën e anëtarëve të kryesisë,
  - d) Të sjellë kopjen e Statutit të klubit i cili duhet të jetë në harmoni me aktet normative të FFK-së,
  - e) Të paguaj shumën e regjistrimit dhe anëtarësinë të caktuar nga organi kompetent i FFK-së,
  - f) Të regjistrojë së paku 20 (njëzet) lojtarë për futbollin e madh, së paku 10 lojtarë për futsall, përkatësisht 15 lojtarë për klubin e futbollit të femrave.
  - g) Që të ketë fushën e vetë apo të siguruar me kontratë,

2. Klubi regjistrohet nën emrin e caktuar dhe organi i FFK-së nuk do ta regjistrojë klubin e të njejtin vend me të njejtin emër.
3. Klubi mund të ndryshoj emrin e vet së paku 40 ditë para fillimit të kampionatit duke e sjellë dokumentacionin përkatës.
4. Klubet e regjistruara në FFK mund të fuzionohen në një të vetëm në bazë të Rregullorës së garave. Klubi i ri duhet të ketë emrin e ri ndryshe nga të mëparshmit, si dhe emrat e mëparshëm të klubeve të fuzionuara shuhet.

### Neni 3

Klubet që plotësojnë kushtet e kërkuara do të bëhen anëtarë të FFK-së në bazë të vendimit të organit kompetent për regjistrim, të publikuara në Fletën Zyrtare të FFK-së, dhe ato gëzojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet si anëtarët e tjerë të FFK-së.

### Neni 4

Klubi pushon të jetë anëtarë i FFK-së, në bazë të vendimit të Kuvendit të Klubit apo sipas dispozitave të akteve normative të FFK-së që e parashohin këtë. Ky vendim publikohet në Fletën Zyrtare.

## **III. REGJISTRIMI I LOJTARËVE**

### Neni 5

1. Një lojtar mund të regjistrohet në FFK për të luajtur për një klub në cilësinë e profesionistit apo amatorit.
2. Vetëm lojtarët e regjistruar mund të marrin pjesë në futbollin e organizuar. Me aktin e regjistrimit lojtari pajtohet që ti respektoj Statutin dhe rregulloret e FIFA-së, UEFA-së dhe FFK-së. Lojtari mund të regjistrohet vetëm në një klub.
3. Lojtari mund të regjistrohet në maksimum tri klube gjatë një sezoni futbollistik. Gjatë kësaj periudhe, lojtari ka të drejtë të luajë në ndeshje zyrtare vetëm për dy klube. Si përjashtim i këtij rregulli, lojtari i cili lëviz mes dy klubeve që i takojnë federatave me sezona të ndryshme (sezoni veror-vjeshtor si e kundërta e sezonit dimëror-pranveror) mund të luajë në ndeshje zyrtare për klubin e tretë, me kusht që s'ka obligime kontraktuale ndaj ish-klubit. Njekohësisht duhet të respektohen rregullat e periudhës së regjistrimit si dhe minimumit kohor për kontratë.

4. Në të gjitha rastet duhet të i ipet konsideratë integritetit sportiv të garave. Në veçanti, një lojtar nuk mund të luajë ndeshje zyrtare për më shumë se dy klube që garojnë në të njëjtin kampionat apo kup gjatë një sezoni futbollistik.

Çdo lojtar i paregjistruar në FFK i cili luan në ndeshje zyrtare të organizuara nga FFK-ja do të konsiderohet si jo legjitim. Komisioni Disciplinor i FFK-së do të sanksionojë lojtarin dhe klubin në bazë të Rregullores Disciplinore.

#### Neni 6

1. Lojtarët profesionist mund të regjistrohen vetëm gjatë dy afateve të rregullta kalimtare, me dy përjashtime.
2. Lojtari amator regjistrohet në periudhat e rregullta të regjistrimit të caktuara nga Komiteti Ekzekutiv (KE).
3. Lojtari i cili regjistrohet për herë të parë mund ta bëjë këtë gjatë tërë vitit garues.

#### **Organi për regjistrimin e lojtarit**

#### Neni 7

1. Regjistrimin e lojtarëve në FFK e bënë organi kompetent i Lidhjes Rajonale të Futbollit së cilës i takon lojtari (më tej: organi regjistruar).
2. Organi regjistruar mban evidencën e lojtarëve të regjistruar për futboll të madh, futsall dhe futbollin e femrave, duke ia dorëzuar komisionit për regjistrimin dhe statusin e lojtarëve të FFK-së (KRSL) e cila mban listën unike të lojtarëve të regjistruar në FFK.
3. Evidenca përmban këto elemente: emrin dhe mbiemrin, datëlindjen, numrin amëz të lojtarit, numrin e librezës sportive dhe emrin e klubit për të cilin është regjistruar. Pjesë integrale e evidences është edhe pasaporti i lojtarit.
4. KE i FFK-së përcakton tekstin e të gjithë formularëve.

#### Neni 8

1. Komisioni për regjistrimin dhe statusin e lojtarëve (KRSL), regjistron lojtarët brenda pesë ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës.
2. Administratori për regjistrim mund të regjistrojë lojtarët pa mbajtjen e mbledhjes së komisionit, nëse janë plotësuar të gjitha kushtet për regjistrim me dokumentacionin përkatës, me kusht që të njohtohet trupi regjistruar që e aprovon këtë.

## **Komisioni për regjistrimin dhe statusin e lojtarëve (KRSL)**

### Neni 9

KRSL i FFK-së kryen punët të përcaktuara me këtë rregullore e posaçërisht:

- I propozon KE-së afatetet për regjistrimin e lojtarëve,
- I propozon KE-së format dhe përmbajtjen e formularëve që kanë të bëjnë me regjistrimin, çregjistrimin, shlyerjen, librezën dhe pasaportën sportive, huazimin dhe të tjera.

### Neni 10

1. KRSL përbëhet prej tre anëtarëve të caktuar nga ana e KE të FFK-së.
2. KRSL cakton sekretarin i cili kryen punët administrativo-juridike.
3. Kryetari udhëheq mbledhjen dhe nënshkruan vendimet.

## **Dokumentacioni për regjistrimin e lojtarëve**

### Neni 11

1. Federata e cila bënë regjistrimin është e obliguar që klubit për të cilin regjistrohet t'i dorëzoj "pasaportin" e lojtarit me të dhënat mbi klubet me të cilat lojtari është regjistruar që nga mosha 12 vjeçare. Një aplikim i lojtarit profesionist duhet të parashrohet së bashku me kopjen e kontratës së tij. FFK-ja ka diskrecionin që të merr për llogari amandamentet apo marrëveshjet shtesë që i janë bashkangjitur asaj.

Dokumentet e nevojshme për regjistrimin e lojtarit janë:

- a) Për lojtarin që regjistrohet për herë të parë:
  - Kërkesa e klubit për regjistrim me dokumente origjinale,
  - Dy fletëparaqitje për regjistrim me fotografi, me nënshkrim të lojtarit dhe zyrtarit të klubit, me vulë të klubit nga e cila një kopje i mbetet klubit dhe njëra organit regjistrues.
  - Libreza e lojtarit me fotografi në „dress sportiv“ me kontrollimin valid mjekësor,
  - Çertifikata e lindjes apo letërnjoftimi,
  - Deklarata e lojtarit se nuk ka qenë i regjistruar më parë në asnjë klub brenda apo jashtë shtetit,
  - Vërtetimi i pagesës së taksës për regjistrim dhe paraqitje,

- Miratimin me shkrim të prindit apo kujdestarit ligjor, nëse lojtari është i mitur,

b) Për lojtarin i cili ndërron klubin:

- kërkesa e klubit për regjistrim me listën e dokumenteve origjinale,
- Dy fletëparaqitje për regjistrim me fotografi, të nënshkruar dhe vulosur nga zyrtari i klubit dhe lojtari nga të cilat një kopje i mbetet organit regjistruës dhe një klubit,
- Fletëlëshimi nga klubi i fundit,
- Fletëçregjistrimi, nëse lojtari ndërron territorin e Federatës kompetente për regjistrim ose dokumentin me të cilin lojtari argumenton se ka kërkuar të njejtin.
- Librezën sportive dhe një fotografi nëse lojtari ndërron territorin e LRF-së,
- Argumentin se kontrata me klubin i ka skaduar, nëse e ka pasur.
- Çertifikatën ndërkombëtare (ITC) të Federatës kompetente nacionale për lojtarët që vijnë nga jashtë ose kthehen nga jashtë, me kërkesë të klubit nga FFK-ja,
- Dy kopje të kontratës ose aneksit nëse janë përmbaaruar,
- Vërtetimi mbi pagesën e taksës për regjistrim dhe paraqitje,

c) Për huazimin e lojtarit:

- kërkesa e klubit për regjistrim me listën e dokumenteve origjinale,
- Dy fletëparaqitje për regjistrim me fotografi, të nënshkruar dhe vulosur nga zyrtari i klubit dhe lojtari,
- Dy kopje origjinale të marrëveshjes ndërmjet klubeve, me të dhënat mbi kohën dhe kushtet tjera të nënshkruar nga zyrtarët e të dy klubeve,
- Çertifikata (ITC) për lojtarin i cili huazohet nga klubi i Federatave tjera nacionale,
- Librezën e futbollit,
- Vërtetimi mbi pagesën e taksës për paraqitje të huazimit.

2. Organi regjistruës i tërheqë vërejtjen paraqitësit të kërkesës së jo kompletuar se nëse brenda së paku 8 ditëve nuk kompletohet e njëjta, do të konsiderohet se kërkesa nuk është bërë.



3. KE i FFK-së para fillimit të periudhës së regjistrimit vendosë mbi lartësinë e taksave për vitin vijues garues.

### **Kërkesa për regjistrim**

#### Neni 12

1. Lojtari mund të regjistrohet ne klub vetëm në bazë të kërkesës për regjistrim me formularin unik të përcaktuar nga FFK-ja.

Kërkesa për regjistrim përmban këto të dhëna:

- Mbiemri, emri i prindit dhe emri i lojtarit,
  - Data dhe vendi i lindjes,
  - Numri amëz,
  - Emri i klubit të kaluar dhe statusi aktual,
  - Eventualisht, dënimi apo suspendimi aktual dhe kohëzgjatja,
  - Data e skadimit te kontratës,
  - Numri i kartonave të verdhë në ndeshjet kampionale dhe për Kup për sezonin aktual.
2. Lojtari obligohet ndaj kërkesës-aplikimit dhe nuk mund të parashtrojë një aplikacion të dytë.
  3. Klubi obligohet të lëshoj fletë lëshimit nëse janë plotësuar kushtet dhe ti jap të dhënat e kërkuara në fletëlëshim.
  4. Pas dhënjes së fletëlëshimit klubi nuk mund të mohoj validitetin e saj dhe ajo vlen deri më ditën e fundit të periudhës së regjistrimit vijues.
  5. Lojtarin e obligon kërkesa për regjistrim dhe ai nuk mund të nënshkruan kërkesë tjetër.  
Nëse pas paraqitjes së kërkesës për regjistrim klubi nuk sjellë materialin për regjistrim brenda 8 ditësh e njehta nuk vlenë. Poashtu ajo nuk vlen nëse në të nuk janë shkruar data e lëshimit apo emri dhe mbiemri i lojtarit.  
Lojtari i cili regjistrohet për herë të parë mund të regjistrohet në çdo kohë.
  6. Fletëlëshimi nuk vlen, automatikisht, pasi që lojtari luan në ndeshjen e parë kampionale apo për KUP për ekipin i cili e ka lëshuar atë.

## **Libreza sportive**

### Neni 13

1. Çdo lojtar i regjistruar ka librezën e vet sportive të lëshuar nga organi regjistruës i FFK-së.
2. Kur lojtari ndërron klubin, klubi është i obliguar t'ja jap librezën sportive përndryshe sanksionohet në bazë të rregullorës disdisciplinore të FFK-së.
3. Nëse lojtari nuk e merr librezën atëherë i lëshohet duplikati me numrin e njëjtë. Nëse libreza humbet apo është e papërdorshme klubi kërkon duplikatin e saj pas pagesës së taksës së përcaktuar. Duplikati duhet të ketë numrin e njëjtë.

## **Çregjistrimi**

### Neni 14

1. Kur lojtari kalon në klubin e LRF-së tjetër duhet të kërkojë vërtetimin e fletëçregjistrimit gjegjësisht shlyrjen nga evidenca e lojtarëve të regjistruar në LRF nga e cila largohet, duke i dhënë të dhënat si në fletëlëshim.
2. Organi regjistruës i LRF-së obligohet që lojtarit t'i lëshoj fletëçregjistrimin pasi që lojtari sjellë fletëlëshimin ose argumenton se e ka kërkuar atë ose se kontrata i ka skaduar ose është shkëputur, brenda 8 ditëve përndryshe konsiderohet se lojtari është çregjistruar.

## **Shlyerja nga anëtarësia**

### Neni 15

1. Çregjistrimi nga evidenca e lojtarëve të regjistruar bëhet në këto raste:
  - a) Në afatin kalimtar me kërkesën e lojtarit nëse i ka plotësuar kushtet për kalim,
  - b) Me kërkesë të klubit kur i kalon anëtarësia në klub,
  - c) Me kërkesë të klubit për të cilin lojtari lajmërohet nëse ka fletëlëshimin, e ka kërkuar atë në afatin veror kalimtar, ose ka marr vendimin për shkëputjen e kontratës nga organi kompetent i FFK-së,
  - d) Pas kalimit të tridhjetë (30) mujave nga dita e braktisjes futbollit profesionist,
  - e) Sipas detyrës zyrtare, (përjashtimi nga organizata e futbollit, vdekja etj).

Organi regjistruës obligohet që çregjistrimin e lojtarit nga anëtarësia të e publikojë në fletën zyrtare të FFK-së.

## **Pasaporti i lojtarit**

### **Neni 16**

Organi regjistruar është i obliguar që t'i deponoj klubit i cili regjistron lojtarin, pasaportën e vërtetuar dhe komplete të lojtarit e cila përmban të dhënat si vijon: të dhënat personale të lojtarit-emrindhe mbiemrin e lojtarit, datëlindjen, vendin e lindjes, shtetësinë, kategorinë e klubit, statusin e tij, emrin e klubit apo klubeve për të cilat lojtari ka qenë i regjistruar nga viti garues kur lojtari i ka mbushur 12 vite, kohëzgjatja e kontratave profesionale numrin e regjistrimit si dhe nënshkrimin dhe vulën e personit të autorizuar të organit regjistruar i LRF-së.

Nëse ditëlindja e 12 e lojtarit bie në mes të dy sezoneve garuese atëherë potencohet emri i klubit me të cilin lojtari ishte në momentin kur ai mbush 12 vjet.

## **IV. NDËRRIMI I KLUBIT**

### **E drejta e ndërrimit të klubit**

### **Neni 17**

1. Lojtarët mund të ndërrojnë klubin në një të njërit nga dy periudhat e regjistrimit të sezonit garues. Përjashtim nga ky rregull është kur lojtari profesionist të cilit i ka skaduar kontrata para kalimit të periudhës së regjistrimit (afatit kalimtar) apo me vendimin e organit të FIFA-s apo organit kompetent të FFK-së iu është shkëputur kontrata profesionale në dëm të klubit, mund të regjistrohet edhe jashtë këtij afati por të drejtën e lojës e fiton vetëm në bazë të dispozitave të kësaj Rregulloreje. FFK mund të merr masa për të evituar abuzimin me këto përjashtime.
2. Lojtari obligohet që klubit t'i sjellë fletëlëshimin apo edhe fletëçregjistrimin.
3. Klubi është i obliguar që t'i përgjigjet kërkesës me shkrim të lojtarit i cili plotëson kushtet e kërkuara dhe t'i lëshoj fletëlëshimin menjëherë ose më së voni pas tri ditësh, në të kundërtën hapet procedura disiplinore nga organi përkatës i LRF-së. Lojtari profesionist të cilit i ka skaduar kontrata nuk ka nevojë për fletëlëshim.

## **Procedura për ndërrimin e klubit gjatë afatit kalimtar**

### Neni 18

1. Lojtari mund të regjistrohet në FFK në bazë të kërkesës valide nga klubi gjatë periudhës kalimtare
2. Nëse lojtari kalon në klub tjetër i cili i takon tjetër LRF-je, përpos posedimit të fletëlëshimit dhe librezës duhet të bëjë kërkesën për çregjistrim në LRF.
3. Nëse lojtari transferohet në një klub që i takon tjetër LRF-je atëherë, përpos fletëlëshimit duhet t'a ketë edhe fletëçregjistrimin nga LRF-ja përkatëse.

## **Regjistrimi pa fletëlëshim dhe pa fletëçregjistrim**

### Neni 19

1. Lojtari i cili dëshiron të regjistrohet gjatë afatit kalimtar por i cili nuk ka marrë fletëlëshimin apo edhe fletëçregjistrimin, përkundër plotësimit të kushteve me këtë Rregullore mund të regjistrohet edhe pa to. Me këtë rast duhet ta argumentojë se i ka kërkuar dokumentet në fjalë, me kopjen e kërkesës.
2. Përjashtimisht, klubi i cili largohet nga garat obligohet t'u jap lojtarëve fletëlëshimin edhe nëse ata kanë kontrata profesioniste në çdo kohë.
3. Lojtarët që regjistrohen në bazë të huazimit nuk kanë nevojë për fletëlëshim apo fletëçregjistrim ndërsa lojtarët profesionistë të cilëve iu ka skaduar kontrata nuk kanë nevojë për fletëlëshim.

## **Kushtet e veçanta për lojtarët e rinj kadetet dhe pionerët**

### Neni 20

1. KE e FFK-së mund të përcaktojë kushte të veçanta për regjistrimin e kategorive të të rinjve , kadetëve dhe pionierëve, me kusht që në nivelin e lartë të garave mund të paraqiten vetëm lojtarët të cilët plotësojnë kushtet nga Propozicionet e garave përkatëse.
2. Lojtarët e regjistruar në bazë të pikës 1 të këtij neni, fitojnë të drejtën e paraqitjes në ndeshjet e ekipeve të kategorive të reja në harmoni me propozicionet përkatëse, ndërsa të drejtën e lojës për ekipin e seniorëve, në bazë të kësaj Rregulloreje.

## **Heqja dorë nga ndërrimi i klubit**

### Neni 21

1. Lojtari i cili ka marrë fletëlëshimin nga klubi, ka të drejtë që me pajtimin e klubit i cili ka bërë kërkesën për regjistrim, të heqë dorë për t'u regjistruar për atë klub para se regjistrimi të është bërë. Poashtu lojtari i pajisur me fletëlëshim dhe fletëçregjistrim e i cili nuk është paraqitur për asnjë klub mund të kthehet në klubin e mëparshëm dhe e fiton të drejtën e lojës në momentin kur organi regjistrues me vendim konstaton se lojtari përkatës ka hequr dorë nga kërkesa për regjistrim në klub tjetër duke ia njohur të drejtën e lojës nga klubi paraprak.
2. Për realizimin e këtij vendimi, klubi i deponon organit regjistrues librezën sportive, deklaratën me shkrim me të cilën vërtetohet heqja dorë nga kërkesa për regjistrim në klubin tjetër si dhe deklaratën me shkrim dhe të vërtetuar të klubit i cili ka bërë kërkesën me të cilën vërtetohet se jep pëlqimin për kthim në klubin paraprak.
3. Klubi duhet të bëjë kërkesën për prishjen e çregjistrimit duke paraqitur edhe deklaratat me shkrim të lojtarit dhe klubit i cili ka bërë kërkesën për regjistrim

## **V. PERIUDHAT E REGJISTRIMIT**

### Neni 22

1. Periudhat e regjistrimit janë periudha verore dhe dimërore kalimtare (afati kalimtar).
2. KE i FFK-së, përcakton periudhën e regjistrimit të cilën ua dërgon organeve të FIFA-së, në afatin dhe mënyrën e përcaktuar nga FIFA.
3. Periudha e regjistrimit veror fillon pas përfundimit të vitit garues dhe parimisht përfundon para fillimit të sezonit të ri dhe nuk mund të zgjatë më shumë se 12 javë.
4. Periudha dimërore e regjistrimit parimisht fillon në mes dy sezoneve garuese dhe nuk mund të zgjatë më shumë se 4 javë.

### Neni 23

1. Periudha e regjistrimit veror vlen për të gjithë lojtarët e të gjitha kategorive, ndërsa periudha dimërore vetëm për lojtarët që kanë fletëlëshim me dokumentacionin e nevojshëm dhe për lojtarët që huazohen.

2. Periudhat e regjistrimit vlejnë edhe për lojtarët të cilëve u skadon kontrata në periudhën e regjistrimit.

### **Publikimi i regjistrimit**

#### Neni 24

1. Regjistrimi i lojtarit duhet të publikohet në fletën zyrtare të FFK-së,
2. Organi regjistruar obligohet që tekstin për publikim dhe materialin e vërtetuar t'ia dorëzoj komisionit për regjistrimin dhe statusin e lojtarit, më se voni deri të mërkurën në orën 16.00.
3. Regjistrimi i cili nuk është publikuar ose është sjellë më vonë publikohet në numrin e radhës, por nëse teksti për publikim është deponuar me kohë atëherë kjo vlen nga dita kur regjistrimi është dashur të shpallet.

#### Neni 25

Regjistri duhet të publikohet më së voni 15 ditë pas kalimit të afatit kalimtar të lojtarëve.

## **VI. FITIMI I SË DREJTËS PËR PARAQITJE**

#### Neni 26

1. Lojtari i regjistruar për një klub fiton të drejtën e lojës në ndeshjet kampionale dhe për KUP, gjatë afatit të rregullt kalimtar, ditën e publikimit të regjistrimit, në këto raste:
  - a) Nëse regjistrohet për herë të parë,
  - b) Nëse regjistrohet për klub të ri gjatë periudhës së regjistrimit,
  - c) Nëse klubi i mëparshëm nuk e ka pararegjistruar, ndërsa vendimi për pararegjistrimin e lojtarit të atij klubi është shpallur,
  - d) Nëse regjistrohet lojtari nën dënim të shqiptuar nga komisioni disiplinor, regjistrimi rrjedh nga dita e publikimit ndërsa e drejta e lojës pas kalimit të dënimit,
  - e) Nëse regjistrohet për klub të ri i cili është fuzionuar me një klub tjetër,
  - f) Nëse regjistrohet si lojtar që ka shkëputur kontratën dhe lajmërohet për klubin tjetër dhe i cili nuk është në procesin e riamaterizimit,

- g) Nëse regjistrohet lojtari professional nga jashtë si dhe lojtari i regjistruar si profesionist në FFK, dhe dëshiron të regjistrohet në statusin e amatorit ( ai fiton te drejtën e lojës si amator pas 30 ditëve nga dita kur zhvillon ndeshjen e fundit si profesionist),
- h) Kur të regjistrohet si lojtar i huazuar,
- i) Nëse regjistrohet si lojtar nga jashtë konsiderohet se është respektuar periudha e regjistrimit nëse lojtari dhe klubi kanë bërë kërkesen për regjistrim brenda afatit të periudhës së regjistrimit,
- j) Nëse regjistrohet si lojtar i huazuar, e ai i kthehet klubit që e ka huazuar pas skadimit të afatit të huazimit. Lojtari i huazuar fiton të drejtën e lojës në bazë të së drejtës së paraqitjes që e ka pasur në klubin që huazon.

#### Neni 27

Lojtari fiton të drejtën e lojës në ndeshjet zyrtare:

- a) Nëse regjistrohet për here të parë për një klub dhe këtë e bënë gjatë tërë vitit,
- b) Nëse regjistrohet për një klub të cilit i'u është shkëputur kontrata me vendim të organit të FFK-së apo FIFA-së, duke fituar të drejtën në bazë të kësaj Rregulloreje.
- c) Nëse regjistrohet si lojtar profesionist të cilit i ka skaduar kontrata me ish klubin para kalimit të afatit kalimtar dhe i cili nuk ka gjetur klub, regjistrohet për klubin e ri gjatë tërë vitit.
- d) Nëse regjistrohet si lojtar i cili është çregjistruar nga regjistri i organit kompetent( brenda afatit kalimtar) dhe regjistrohet në çdo kohë, përpos në rastin e përcaktuar me pikën c të këtij neni,
- e) Nëse regjistrimi për klubin e ri prishet me vendim të organit kompetent, lojtari mbetet anëtar i klubit aktual me të drejtë loje që e ka pasur, nëse ka kontratë dhe nëse nuk është çregjistruar nga LRF. Nëse është çregjistruar atëherë duhet të regjistrohet përsëri gjatë afatit kalimtar,
- f) Nëse regjistrohet si lojtar i klubit i cili ka hequr dorë nga garat.

#### **Regjistri i lojtarëve profesionist**

#### Neni 28

1. Lojtarët të cilët bëjnë apo shkëputin kontratë profesionale regjistrohen në një evidence të posaçme të cilën e udhëhëq administratori i regjistrimit dhe KRSL,
2. Organi regjistruar i LRF mban evidence të posaçme të lojtarëve të regjistruar në FFK nga jashtë dhe të njejtën ia deponon KRSL-së.

## **Afatet**

### Neni 29

Nëse dita e fundit e të gjitha afateve të përkatuara me këtë rregullore bie në ditën e diel, ose gjatë festës, afati zgjatet për ditën e parë të punës.

## **Huazimi i lojtarit profesional**

### Neni 30

1. Lojtari profesionist mund ti huazohet klubit tjetër në bazë të marëveshjes së shkruar ndërmjet lojtarit dhe klubeve përkatëse para organit kompetet të FFK-së,
2. Huazimi i lojtarit është subjekt i rregullave të njejta të cilat aplikohen për transferimet e lojtarëve, përfshirë këtu edhe rregullat për kompenzimin për trajnim dhe zhvillim dhe mekanizmin e solidaritetit.
3. Periudha minimale për huazim është koha mes dy periudhave të regjistrimit.

### Neni 31

1. Një klub mund të huazojë dhe të regjistrojë nga klubet tjera më së shumti 6 lojtarë, ndërsa më së shumti 2 lojtarë nga i njëjti klub.
2. Klubi mund t'a huazoj lojtarin e vet vetëm për periudhën sa ai ka kontratë valide me të.
3. Klubi i cili huazon një lojtar duhet ti përmbushë obligimet e kontratës ndaj lojtarit, përpos nëse ata nuk e rregullojnë këtë çështje me kontratë të veçantë.
4. Regjistrimi i lojtarëve të huazuar publikohet në fletën zyrtare dhe në librezën sportive shënohet si e përkohshme.

## **Regjistrimi i lojtarëve shtetas të huaj, lojtarëve me shtetësi të dyfishtë dhe shtetasve tonë që vijnë nga klubet e jashtme**



#### Neni 32

1. Regjistrimi i lojtarëve shtetas të huaj, lojtarëve me shtetësi të dyfishtë dhe shtetasve tonë që vijnë nga klubet e jashtme bëhet në bazë të procedurës së përcaktuar nga organizata ndërkombëtare e futbollit (FIFA).
2. Lojtari, shtetas i huaj duhet të ketë qëndrimin e përkohshëm ose të përhershëm në Kosovë, të miratuar nga organi kompetent shtetëror në bazë të ligjit përkatës të Kosovës.
3. Ekipet e Superligës kanë të drejtë të regjistrojnë 6 lojtarë shtetas të huaj, Liga e Parë 4 ndërsa Ligat e dyta nga 2.

#### **Çertifikata ndërkombëtare e transferit (ITC)**

#### Neni 33

1. Asnjë lojtar (amator apo profesionist) nuk mund të regjistrohet për klubin e federatës tjetër nacionale nëse më parë nuk e ka Çertifikatën Ndërkombëtare të Transferit (mëtej ITC).

#### Neni 34

1. ITC lëshohet në bazë të kërkesës së Asociacionit të huaj internacional në bazë të Rregullores për statusin dhe transferin e lojtarëve të FIFA-së,
2. ITC lëshohet nga shërbimi profesional i FFK-së – sektori ndërkombëtar e mbikqyrur dhe nënshkruar nga Sekretari i përgjithshëm.
3. ITC për lojtarët në cilësi amatori lëshohet në mënyrë tradicionale ndërsa ITC për lojtarët profesionist vetëm nëpërmjet sistemit të FIFA-s (TMS).
4. ITC lëshohet pa pagesë dhe pa kurrëfarë kushtëzimi.

#### Neni 35

1. Sektori përkatës i FFK-së njofton klubin vendas për kërkesën e bërë për lëshimin e ITC, për klubin e asociacionit tjetër duke kërkuar vërtetimin se mes lojtarit dhe klubit nuk ekziston asnjë pengesë juridike për kalimin e tij në ndonjë klub tjetër,
2. Klubi është i obliguar t'i përgjigjet organit të FFK-së brenda 5 ditëve nga dita kur klubi është lajmëruar,
3. Në raste kontestuese organi i FFK-së, mund ta ftojë lojtarin për të sqaruar rastin.

### Neni 36

1. FFK-ja është e obliguar që brenda 7 ditëve nga marrja e kërkesës për lëshimin e ITC :
  - a) Të lëshoj ITC për Asociacionin e ri, ose
  - b) Të informoj Asociacionin e ri për shkaqet e refuzimit të ITC bazuar në kontratën mes lojtarit dhe klubit, dhe se nuk ka pasur marrëveshje të përcaktuar më herët për prishjen e saj para skadimit të kontratës.
  
2. Nëse asociacioni i ri nuk merr përgjigje për kërkesën e ITC brenda 30 ditëve mund të regjistroj menjëherë profesionistin e ri në bazë të përkohshme (regjistrim i përkohshëm). Regjistrimi i përkohshëm bëhet permanent 1 vit pas bërjes së kërkesës për ITC. Komisioni për statusin e lojtarëve mund të hedhë poshtë regjistrimin e përkohshëm nëse brenda kësaj periudhe 1 vjeçare ish Asociacioni prezanton argumente valide duke spjeguar se pse nuk iu është përgjigjur kërkesës për ITC.

### Neni 37

1. ITC lëshohet në formularin e përcaktuar nga FIFA.
2. Krahas lëshimit të ITC për lojtarin profesionist apo amator deponohet edhe pasaporti i lojtarit.
3. FFK-ja është e obliguar që krahas lëshimit të ITC-së, të informojë Asociacionin e huaj për dënimet aktuale që ka lojtari.

### Neni 38

1. Kur një lojtar që vjen nga Asociacioni i huaj regjistrohet për një klub të FFK-së, ai klub i bënë kërkesën FFK-së për të kërkuar ITC nga Asociacioni i huaj.
2. FFK-ja është e obliguar të kërkoj ITC në bazë të kërkesës së klubit. Ish Asociacioni menjëherë duhet të kërkoj nga ish-klubi dhe lojtari profesionist që të konfirmojnë se kontrata i ka skaduar, se ka pasur marrëveshje për prishje të mëhershme të kontratës apo se ekziston kontest ligjor. FFK-ja duhet t'i përgjigjet Asociacionit përkatës brenda 7 ditësh.
3. Në rast se në FFK deponohet një ITC e ndonjë Asociacioni tjetër, të cilën FFK-ja nuk e ka kërkuar, atëherë lojtari nuk mund të regjistrohet për klubin në territorin e FFK-së.

4. Lojtari amator mund të regjistrohet në njëren nga dy periudhat e regjistrimit të caktuara nga Asociacioni përkatës. Pas kërkesës, Asociacioni i ri duhet të kërkojë menjëherë ITC-në nga Asociacioni i kaluar brenda shtate ditësh duke u bazuar në procedurën e njejtë sipas nenit 36 pika 2. e kësaj Rregullorje.

#### Neni 39

1. Klubet e Asociacioneve nacionale dhe lojtarët profesionistë në bazë të Rregullorës së FIFA-së për statusin dhe transferin e lojtarëve mund të bëjnë kontrata mbi huazimin, por lojtarët e huazuar mund të regjistrohen vetëm gjatë afateve kalimtare.
2. Për kushtet u huazimit merren vesh në formë të shkruar lojtari dhe klubet përkatëse, dhe me këtë rast klubi që ka huazuar lojtarin nuk mund ta transferoj atë për klubin e tretë pa autorizimin e shkruar të klubit dhe pajtimin e lojtarit përkatës.

### **Mbrojtja e lojtarëve të mitur**

#### Neni 40

1. Transferi ndërkombëtar i lojtarëve nën moshën 18 vjeçare është i ndaluar.
2. Aplikohen tri përjashtime në këtë rregull:
  - a) Prindërit e lojtarit shkojnë në shtetin në të cilin është klubi i ri për arsye që nuk janë të lidhura me futboll.
  - b) Transferi kryhet brenda teritorit të Bashkësisë Europiane (BE) ose Areas Ekonomike Europiane (EEA) dhe lojtari është i moshës mes 16 dhe 18 vjeq. Me këtë rast klubi i ri duhet t'i përmbushë minimumin e këtyre kushteve.
    - Duhet t'i ofrojë lojtarit edukimin adekuat apo trajnimin në futboll në linjë me standardet më të larta nacionale,
    - Duhet t'i garantojë lojtarit edukim apo trajnim akademik shkollor apo profesional, shtuar edukimit apo trajnimit të tij futbollistik të cilat do ti mundësonin lojtarit të vazhdojë karrierën tjetër përpos të futbollit nëse ndalon të luajë futbollin profesionist,
    - Duhet të bëjë të gjitha aranzhimet e nevojshme për të siguruar se lojtari është përkujdesur në mënyrën më të mire të mundshme (optimumi i standardit jetësor në familjen nikoqire ose në akomodimin e klubit përcaktimin e përgjegjës në klub).

- Duhet që në regjistrimin e lojtarit të tillë ti ofron asociacionit relevant fakte se është duke i përmbushur obligimet e lartpërmendura.
- c) Lojtari që jeton jo më larg se 50 km nga kufiri nacional dhe klubi për të cilin lojtari dëshiron të regjistrohet në asociacionin fqinj është poashtu 50 km brenda të atij kufiri. Distance maksimale në mes të vendbanimit të lojtarit dhe selisë së klubit duhet të jetë 100 km. Në këto raste lojtari duhet të vazhdojë të jetojë në shtëpi dhe dy asociacionet duhet të japin pëlqimin e tyre eksplicit.
3. Kushtet e këtij neni duhet të aplikohen poashtu tek çdo lojtar i cili më parë nuk ishte i regjistruar për asnjë klub dhe nuk është i nacionalitetit të shtetit në të cilin ai dëshiron të regjistrohet për herë të parë.
  4. Çdo transfer ndërkombëtar lidhur me paragrafin 2 dhe çdo regjistrim i parë lidhur me paragrafin 3 është subjekt i aprovimit të nënkomitetit të FIFA-së të përcaktuara nga Komiteti për statusin e lojtarëve për këtë qëllim. Kërkesa për aprovim duhet të deponohet nga asociacioni i cili dëshiron të regjistrojë lojtarin. Ish asociacionit duhet t'i ipet rasti të parashtrij pozicionin e tij. Aprovimi nga nënkomiteti duhet të sigurohet para çdo kërkesë nga një asociacion për një certificate të transferit ndërkombëtar dhe/ose regjistrimi i pare, çdo shkelje e kësaj rregulle do të sanksionohet nga komisioni disiplinor në bazë të kodeksit disiplinor të FIFA-së. Përpos asociacionit i cili ka dështuar ti drejtohet nënkomitetit sanksionet mund ti shqiptohen edhe ish asociacionit për lëshimin e ITC pa aprovimin e nënkomitetit, si dhe për klubet të cilat kanë arritur një marrëveshje për transferimin e të miturit.

## **Regjistrimi dhe raportimi i të miturve në akademi**

### Neni 41

1. Klubi i cili ka një akademi të lidhur në mënyre ligjore financiare apo defacto me atë klub obligohet t'i paraqes të gjithë lojtarët e mitur të cilët vijnë në akademinë në asociacionin në të cilin teritorialisht vepron.
2. FFK-ja është e obliguar të sigurojë që të gjitha akademitë pa lidhjet ligjore, financiare apo defacto me një klub:
  - a) Të drejtojnë klubin i cili merr pjesë në kampionatin adekuat të garave të gjithë lojtarët të lajmrohen në LRF të FFK-së, në territorin në të cilin akademia vepron, ose të regjistruara në vet klubin,

- b) T'i paraqesë të gjithë të miturit të cilët vijojnë akademinë me qëllim të trajnimit, asociacionit në të cilin teritorialisht akademia vepron.
3. FFK-ja mban regjistrin me emrat dhe datat e lindjes së të miturve të cilet janë paraqitur nga klubi apo akademia,
  4. Nëpërmes aktit të paraqitjes, akademit dhe lojtarët marrin përsipërr praktikimin e futbollit në pajtim me Statutit e FIFA, dhe të respektojnë dhe të promovojnë parimet etike të futbollit të organizuar.
  5. Çdo shkelje e këti regulli sanksionohet nga komisioni Dicipinor në pajtim me kodin disciplinor të FIFA-së,
  6. Neni 41 paragrafi 2 pika a) duhet të aplikohet poashtu për t'i paraqitur të gjithë lojtarët e mitur të cilët nuk janë shtetas të Kosovës, por dëshirojnë të paraqitën në teritorin e tyre,

### **Vërtetimi i regjistrimit të lojtarit, kundërshtimi dhe ankesa**

#### Neni 42

1. Organi regjistrues kompetent obligohet që KRSL-së menjëherë t'i dorëzojë vendimin për regjistrimin e lojtarëve.
2. KRSL obligohet që brenda dy ditësh të publikojë vendimet e organit regjistrues, ose të refuzojë apo kthejë lëndën organit regjistrues i cili pastaj do ti eliminojë mangësitë. Në raste të jashtëzakonshme kryetari i komisionit autorizohet të vendosë për lëndën, mirëpo ky rast duhet të miratohet nga komisioni në përbërje të plotë në mbledhjen e radhës.
3. Kundër vendimit të KRSL, pala e pakënaqur mund t'i ankohet komisionit për ankesa brenda tetë ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

### **Kundërshtimi**

#### Neni 43

1. Kundërshtimi kundër vendimit mbi regjistrim i parashtrohet organit kompetent regjistrues dhe këtë mund ta bëjnë të gjithë palët e interesuara, anëtarë të FFK-së.
2. Kundërshtimi parashtrohet brenda 5 ditësh nga dita e pranimit të vendimit mbi regjistrim. Bashkangjitur dorëzohet kopja e pagesës së taksës e caktuar nga KE me kusht që nëse aprovohet kundërshtimi shuma i kthehet kundërshtuesit.

#### Neni 44

1. Kundërshtimet jashtë kohës dhe ato pa taksë të paguar, refuzohen.
2. Kundërshtimet e bëra jashtë kohës vlerësohen në bazë të dorëzimit të saj direkt, të protokoluara në FFK apo me datën e letrës së porositur, me datën e vulës postare.
3. Kundërshtimi duhet të argumentohet me të dhëna të bazuara në lëndën në fjalë.

#### Neni 45

1. Vendimi për kundërshtim bëhet në afat prej 5 ditëve, nga dita e paraqitjes së kundërshtimit dhe u dorëzohet menjëherë palëve të interesuara.
2. Nëse organi regjistruar vlerëson se kundërshtimi është i bazuar, menjëherë suspendon regjistrimin e lojtarit dhe do të vërteton regjistrimin valid. Kjo duhet të bëhet brenda 8 ditëve.

### **Ankesa**

#### Neni 46

1. Ndaj vendimit të organit regjistruar lidhur me kundërshtimin në regjistrim, pala e pakënaqur ankohet në KRSL, si organ i shkallës së dytë, në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, me taksën e paguar,
2. KRSL obligohet të vendosë ndaj ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së ankesës.
3. Vendimi i KRSL mund të apelohe në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së vendimit në Komisionin për Ankesa që merr vendim përfundimtar.

#### Neni 47

1. Në bazë të paraqitjes së kundërshtimit dhe ankesës, regjistrimi mund të:
  - a) Vërtetohet,
  - b) Anullohet dhe
  - c) Përmirësohet,
2. Regjistrimi i lojtarit mund të anulohet edhe në bazë të vendimit të KRSL dhe ajo konsiderohet si të mos kishte ekzistuar,
3. Vendimi mbi anulimin, përkatësisht përmirësimin e regjistrimit publikohet në fletën zyrtare të FFK-së.

## **Kundërvajtjet gjatë regjistrimit të lojtarëve**

### Neni 48

1. Nëse në bazë të kundërshtimit të rregullt, gjegjësisht ankesës, apo në bazë të detyrës zyrtare të organit kompetent, konstatohet se një lojtar është i regjistruar për një apo më shumë klube, KSRL do t'i anuloj të gjitha regjistrimet e pa rregullta duke lënë në fuqi vetëm regjistrimin e rregullt.
2. Nëse pas kalimit të afatit për kundërshtim, konstatohet se lojtari është regjistruar për dy apo më shumë klube, KSRL do t'i anuloj të gjitha regjistrimet e mëparshme, ndërsa lojtari i mbetet klubit në bazë të regjistrimit të fundit, nëse nga regjistrimi i fundit kanë kaluar së paku 2 vite dhe nëse nuk bëhet fjalë për lojtarin i cili ka pasur kontratë me klubin (sepse mbetet anëtar i klubit me të cilin ka kontratë).
3. Nëse dy (2) apo më shumë klube njëkohësisht bëjnë kërkesë për regjistrim të lojtarit të njejtë, organi regjistruues e bënë këtë për klubin i cili ka bërë kërkesën më herët.
4. Nëse lojtari është i regjistruar për klube të organeve të ndryshme regjistruuese, atëherë procedurën dhe marrjen e vendimit e bënë KSRL i FFK-së.

### Neni 49

Kundër lojtarit dhe klubit si dhe ndaj personit përgjegjës të organit regjistruës të cilët bëjnë kundërvajtje lidhur me regjistrimin e lojtarit, inicohet procedura disiplinore në bazë të Rregullorës Disiplinore të FFK-së.

## **Paraqitja e lojtarëve për Përfaqësuësen**

### Neni 50

1. Klubet e FFK-së janë të obliguara të lirojnë lojtaret e vet të regjistruar për tu paraqitur për Përfaqësuesen e Kosovës, nëse kanë të drejtë në bazë të nënshtetësisë, me kusht që ndeshjet të zhvillohen në datat e caktuara në bazë të kalendarit ndërkombëtar të koordinuar.
2. Lojtarët duhet të lirohen edhe për ndeshjet në bazë të vendimit të posaçëm të Komitetit Ekzekutiv të FIFA-së,
3. Për mos respektimin e këtyre rregullave ndaj klubit inicohet procedura disiplinore.

#### Neni 51

Për të gjitha çështjet lidhur me lejimin e lojtarëve për Përfaqësuese, aplikohen dispozitat e Rregullores për statusin dhe transferin e lojtarëve të FIFA-së.

### **VII. STATUSI I LOJTARËVE**

#### Neni 52

Lojtari i cili merr pjesë në garat zyrtare të organizuara nga Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), i regjistruar në klubin e meshkujve, femrave apo të futsal-it, mund të ketë status të profesionistit apo të amatorit.

#### **Lojtari amator**

#### Neni 53

1. Lojtari amator mund të merr pjesë në të gjitha nivelet e garimit dhe konsiderohet ai lojtar i cili nuk lidhë kontratë me shkrim por merr kompensim material për shpenzime të cilat shfaqen për pjesëmarrjen e tij në gara, shpenzimet e udhëtimit, hotelit, pajisjeve sportive etj..

Këto shpenzime nuk mund të rrezikojnë statusin e amatorit që ka lojtari.

2. Klubi është i obliguar që lojtarit amator t'i bëjë sigurimin në rast lëndimi apo sëmundjeje, nëse janë të lidhura me kohën e ndeshjeve, ushtrimeve, udhëtimeve apo paraqitjeve tjera për klubin.

#### **Riamaterizimi**

#### Neni 54

1. Lojtari i regjistruar si profesionist nuk mund të regjistrohet përsëri si amator pa kaluar 30 ditë nga dita kur ai ka zhvilluar ndeshjen e fundit si profesionist.
2. Pas fitimit të sërishëm të statusit të amatorit nuk paguhet kompensimi për trajnim dhe zhvillim të lojtarit.
3. Nëse lojtari regjistrohet sërish si profesionist brenda afatit prej 30 muajve nga fitimi i statusit të amatorit, klubi i tij i ri paguan kompensimin për trajnim dhe zhvillim në bazë të kësaj Rregulloreje.



## **Ndalimi i aktivitetit**

### Neni 55

1. Lojtari profesionist i cili përfundon karrierën, pas skadimit të kontratës dhe amatori i cili ndërpren aktivitetin, mbeten të regjistruar në FFK për periudhë 30 mujore.
2. Kjo periudhë fillon nga dita kur lojtari është paraqitur për herë të fundit për klubin në ndeshje zyrtare.

## **Lojtari profesionist**

### Neni 56

1. Lojtari profesionist është lojtari i cili ka lidhur kontratë të shkruar dhe të regjistruar në FFK, i cili merret me futboll si profesion dhe për këtë merr të ardhura personale dhe pagesa tjera të parapara me kontratën e tij, që janë më të mëdha sesa shpenzimet efektive për zhvillimin e aktivitetit të tij.
2. Lojtari me kontratë profesioniste ka status të punëmarrësit në marrëdhënie pune dhe duhet të sigurohet nga ana e klubit për të gjitha llojet e lëndimeve, invaliditetit dhe vdekjes që mund të shkaktohen lidhur me aktivitetin e tij në klub.  
Përpos obligimeve në fjalë klubi është i obliguar t'i paguaj obligimet shtesë për sigurim pensional-invalidor dhe shëndetësor.
3. Në bazë të dispozitave të Rregullores së FIFA-s për statusin dhe transferin e lojtarëve, lojtari i cili lidh kontratë dhe është mbi 16 vjeç, ka statusin e lojtarit profesionist.

## **Lidhja e kontratës profesionale**

### Neni 57

1. Lojtari profesional lidhë kontratë profesionale (kontratë pune) me klubin.
2. Me këtë kontratë përcaktohen afati, shuma e pagesave, mënyra e pagesës si dhe rregullohen të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë për sigurimin social dhe të punës në bazë të ligjit.
3. Kontrata profesionale duhet të jetë në harmoni me këtë Rregullore dhe Rregulloren e FIFA-së për statusin dhe transferin e lojtarëve,

#### Neni 58

Kontratat profesionale mund të lidhen jo vetëm nga klubet e Superligës dhe Ligës së parë të Kosovës.

#### Neni 59

1. Kontrata profesionale duhet të jenë të nënshkuara nga lojtari, zyrtari i autorizuar i klubit si dhe zyrtari i FFK-së.
2. Nënshkrimi i bërë në kontratë nuk mund të tërhiqet në mënyrë të njëanshme.
3. Për lojtarin nën 18 vjet nënshkruhet përpos tij, edhe prindi ose kujdestari i tij ligjor.
4. Kontratat bëhen në 2 kopje origjinale. Kontratat të cilat nuk janë të bëra siç parashihet pika 1 e këtij neni nuk gëzojnë mbrojtjen juridike nga ana e organeve të FFK-së.
5. Kontrata parimisht bëhet gjatë afatit kalimtar dhe i obligon palët kontraktuese menjëherë, ndërsa ndaj palës së tretë prodhon efekt juridik kur të vërtetohet nga KRSL dhe e njëjta publikohet në fletën zyrtare.

#### Neni 60

1. Kohëzgjatja minimale e kontratës profesionale është periudha nga dita e lidhjes së saj e deri në fund të sezonit garues, ndërsa më e gjata është 5 vite.
2. Lojtari më i ri se 18 vjet nuk mund të nënshkruan kontratë më të gjatë se 3 vite. Nëse ajo bëhet më gjatë atëherë konsiderohet e paqenë.
3. Me lojtarin më të ri se 16 vjet nuk mund të lidhet kontratë profesionale.

#### Neni 61

Data e lidhjes së kontratës dhe kohëzgjatja e saj përshkruhen në librezën sportive dhe pasaportin e lojtarit.

#### Neni 62

1. Validiteti i kontratës profesionale nuk varet nga rezultatet e kontrollimit mjekësor,
2. Të gjitha kontrollimet mjekësore, hulumtimet dhe testet shëndetësore për aftësitë e lojtarit bëhen para lidhjes së kontratës.

#### Neni 63

Dispozitat e kontratave që janë në kundërshtim me këtë Rregullore dhe Rregulloren e FIFA-së për statusin dhe transferin e lojtarëve, konsiderohen si të paqena.

#### Neni 64

1. KE i FFK-së përcakton formularët për kontrata profesionale të cilat përmbajnë kushtet minimale të cilat nuk mund të ndryshohen. Lojtari dhe klubi mund të bëjë aneks të veçantë për të plotësuar marrëdhënjet e tyre por ai vlen vetëm nëse i është bashkangjitur kontratës dhe është i vërtetuar në FFK.

#### Neni 65

Formularët për këto kontrata publikohen në fletën zyrtare së paku 20 ditë para fillimit të afatit kalimtar.

### **VIII. MBAJTJA E STABILITETIT KONTRAKTUES NDËRMJE LOJTARIT DHE KLUBIT**

#### **Respektimi i kontratës**

#### Neni 66

1. Kontrata në mes të lojtarit dhe klubit ndalon të vlejë pas kalimit të afatit për të cilin është lidhur, me marrëveshje të dyanshme për shkëputje të kontratës ose me vendimin e organit kompetent të FIFA-s apo FFK-së.
2. Shkëputja e njëanshme e kontratës gjatë sezonit garues nuk lejohet.

#### **Shkëputja e kontratës për shkaqe të arsyeshme**

#### Neni 67

1. Shkëputjen e kontratës për shkaqe të arsyeshme, në rast se lojtari dhe klubi nuk mund të mirren vesh, e bënë KRSL dhe në rast ankese në DHNZK.
2. Shkëputjen e kontratës për shkaqe të arsyeshme, mund ta kërkojnë si lojtari ashtu edhe klubi.
3. Shkaqet e arsyeshme për shkëputje të kontratës janë të natyrës faktike dhe vlerësohen nga rasti në rast, me kërkesë të lojtarit apo të klubit.
4. Kontrata mund të shkëputet për shkaqe të arsyeshme pa shqiptimin e sanksioneve financiare apo sportive.

5. Pala e cila ka shkëputur kontratën për shkaqe të arësyeshme nuk do të ketë kurfarë pasoja juridike apo obligim për dëmshpërblim, por mund të ketë të drejtë në dëmshpërblim.

### **Shkëputja e kontratës për shkaqe të arësyeshme sportive**

#### Neni 68

1. Lojtari mund të kërkojë për shkaqe të arësyeshme sportive shkëputjen e kontratës para kalimit të afatit, nëse behet fjalë për një profesionist të afirmuar i cili në sezonin garues është paraqitur në më pak se 10 % të ndeshjeve zyrtare të klubit të tij. Për vlerësimin e këtyre rasteve mirren parasysh rrethanat në të cilat lojtari gjindet, ndërsa shkaqet e arësyeshme sportive do të shqyrtohen nga rasti në rast.
2. Në rastet e përmendura nga pika 1 e këtij neni nuk shqiptohen sanksionet sportive, ndërsa dëmshpërblimi për shkëputje të kontratës mund të paguhet.
3. Në këtë bazë lojtari mundet që me anë të formës së shkruar të kërkojë shkëputjen e kontratës vetëm në bazë të afatit prej 15 ditësh pas ndeshjës së fundit zyrtare të klubit për të cilin është i regjistruar.
4. Shkëputjen e kontratës për shkaqe të arësyeshme sportive, në rast se lojtari dhe klubi nuk mund të mirrën vesh, e bënë KRSL.
5. Shkëputja e kontratës në këtë bazë nuk e përjashton të drejtën e klubit për kompensim për trajnimin dhe zhvillimin e lojtarit.

### **Pasojat e shkëputjes së kontratës pa shkaqe të arësyeshme**

#### Neni 69

1. Në rastet kur kontrata shkëputet në mënyrë të njëanshme pala e cila e bënë shkëputjen mbart pasojat adekuate.
2. Nëse lojtari profesionist dhe klubi nuk e kanë përcaktuar dëmshpërblimin për rast të shkëputjes së njëanshme të kontratës pa shkak të arësyeshëm apo pa shkak të arësyeshem sportiv dëmshpërblimi për mos respektimin e kontratës do të mbështetet në ligjin, dhe në të gjitha kriteriumet tjera objektive.  
Këto kriteriume do të inkludojnë shpërblimet dhe benificionet në të cilat lojtari ka të drejtë sipas kontratës apo kontratës së re, ku është përfunduar koha e kontratës aktuale deri më së shumti 5 vite, taksat dhe hargjimet të cilat ish klubi i ka paguar

gjatë kohës së kontratës, si dhe a është bërë shkelja e kontratës gjatë periudhës së mbrojtur.

#### Neni 70

1. E drejta në dëmshpërblim nuk mund të bartet në personin e tretë.
2. Nëse nga lojtari profesionist kërkohet të paguaj dëmshpërblim, lojtari dhe klubi i tij i ri do të jenë bashkarisht dhe të ndarë përgjegjës për pagimin e dëmshpërblimit. Shuma e dëmshpërblimit mund të caktohet në kontratë apo që palet të mirren vesh.

### **Periudha e mbrojtjes**

#### Neni 71

Periudha e mbrojtjes është periudha kohore prej tri sezonave të plotë apo tri viteve, varësisht cila është më parë, pas hyrjes në fuqi të kontratës, nëse një kontratë e tillë është lidhur para ditëlindjes së 28 të lojtarit profesionist, ose periudha prej 2 sezonave të plota apo 2 viteve, varësisht cila vijë më parë, pas hyrjes në fuqi të kontratës, nëse një kontratë e tillë është e lidhur pas ditëlindjes së 28 të lojtarit profesionist.

#### Neni 72

1. Lojtari profesionist i cili shkëput kontratën në periudhën e mbrojtur dënohet me ndalesë loje në ndeshjet zyrtare në kohëzgjatje prej 4 muajve. Në raste me rrethana vështirësuese ndalesa zgjatë 6 muaj. Në të gjitha rastet ky sanksion sportiv do të hyjë në fuqi në fillim të sezonit të ri të klubit të ri.
2. Shkëputja e njëanshme e kontratës pa shkaqe të arësyeshme apo pa shkaqe të arësyeshme sportive pas periudhës së mbrojtur, nuk do të shkakton shqiptimin e sanksioneve sportive. Me gjithë atë masa disiplinore mund të shqiptohen për shkak të mos informimit për shkëputje të kontratës në afat prej 15 ditësh nga ndeshja e fundit zyrtare në sezon (kampionale apo KUP) për klubin për të cilin është regjistruar. Periudha e mbrojtjes fillon përsëri kur, gjatë rinovimit të kontratës kohëzgjatja e kontratës së mëparshme vazhdohet.

#### Neni 73

1. Klubi i cili shkëput kontratën pa shkaqe të arësyeshme ose klubi i cili shtyn lojtarin në shkëputje të kontratës në kohën e periudhës së mbrojtjes, dënohet me ndalesën

- për regjistrim të lojtarëve të ri Nacional dhe Internacional për dy periudha regjistrimi. Konsiderohet se klubi ka shtyer lojtarin në shkëputje të kontratës, nëse lojtari i cili ka shkëputur kontratën me ish klubin pa shkaqe të arësyeshme, lidhë kontratë me të, përpos nëse nuk konstatohet ndryshe.
2. Çdo person (zyrtaret e klubeve, agjentet e lojtareve, lojtaret etj), i cili përndryshe është i obliguar t'i respektoj rregulloret e FFK-së si dhe Statutin dhe Rregulloret e FIFA-së, e i cili sillet në atë mënyrë për të cilën shtyn në shkëlqen e kontratës në mes të lojtarit profesionist dhe klubit, me qëllim të transferimit të lojtarit dënohet në bazë të Rregullores Disciplinore të FFK-së.

### **Dispozitat e veçanta lidhur me kontratën ndërmjet lojtarit profesionist dhe klubit**

#### Neni 74

1. Klubi i cili dëshiron të lidh kontratë me një lojtar profesionist, obligohet që në formë të shkruar të njoftoj klubin e tij aktual para se të hyjë në negociata me lojtarin profesionist.
2. Lojtari profesionist mund të lidh kontratën me klubin tjetër vetëm nëse kontrata e tij me klubin aktual ka skaduar apo do të skadoj në 6 muajt e ardhshëm. Për çdo shkelje të kësaj dispozite do të shqiptohen sanksionet përkatëse.
3. Nëse në lidhjen e kontratës është i përfshirë edhe agjenti i licencuar për lojtar, emri i tij do të ceket në kontratë.
4. Shfrytëzimi i shërbimeve të agjentit jo të licencuar gjatë negociatave, lidhjes së kontratës apo dhënja e çfarëdo kompensimi këtij "agjenti", konsiderohet kundërvajtje disiplinore dhe aplikohet Rregullorja Disciplinore e FFK-së.

#### Neni 75

1. Nëse lojtari profesionist lidh më shumë se një kontratë për periudhën e njëjtë do të aplikohen dispozitat e parapara me këtë Rregullore.
2. Klubi nuk duhet të nënshkruaj kontratë e cila i mundëson palës tjetër të kontratës ose palës së tretë, të fitoj mundësinë të ndikoj në pamvarësinë, politikën apo në suksesin e ekpit të atij klubi, e në çështjet që janë të lidhura me punësimin apo transferin.

3. Komisioni Disciplinor i FFK-së mund të shqiptoj masa disiplinore klubeve, të cilat nuk i përmbahen obligimeve të definuara me pikën e mëparshme.

### **Kontestet lidhur me kontrata**

#### Neni 76

1. Kontestet lidhur me kontrata nën nivelin nacional, që në fakt nuk kanë dimension ndërkombëtar e zgjidh KRSL, i cili vendosë mbi :
  - Statusin e lojtarëve,
  - Validitetin e kontratës ndërmjet lojtarit profesionist dhe klubit,
  - Dëmshpërblimi dhe shuma e saj,
  - Arsyeshmërinë e tërheqjes nga kontrata për shkaqe të arsyeshme apo të arsyeshme sportive, dëmshpërblimin për shkak të tërheqjes së njëanshme nga kontrata, kontestin për shkak të mospërmbushjes së obligimeve të kontratës.
2. KRSL vendosë për kërkesat, me kusht që nuk kanë kaluar më shumë se dy vite nga rasti i cili ka sjellë deri të kontesti.
3. KRSL vendosë në bazë të Rregullores mbi punën e komisionit për RSL, të miratuar nga KE i FFK-së.

#### Neni 77

Vendimi i KRSDL mund të apelohe në Komisionin për Ankesa, i cili është final.  
Si instancë e fundit që ka karakter arbitrar është DHNZK.

## **IX. KOMPENZIMI PËR TRAJNIM DHE ZHVILLIM TË LOJTARIT DHE MEKANIZMI I SOLIDARITETIT**

### **Kompenzimi për trajnimin dhe zhvillimin e lojtarit**

#### Neni 78

1. Kompenzimi për trajnimin dhe zhvillimin e lojtarit (më tej: kompenzimi) i paguhet klubit/klubeve të cilat kanë trajnuar lojtarin, kur lojtari nënshkruan kontratën e parë profesionale si dhe pas çdo transferi të tij deri në fund të sezonit garues në të cilën lojtari mbush 23 vjet.
2. Kur lojtari amator kalon në klub tjetër pa e ndryshuar statusin, ish klubi i tij apo klubet nuk kanë të drejtë në kompenzim.
3. Trajnimi dhe zhvillimi i lojtarit ( mëtej: trajnimi) bëhet ndërmjet vitit 12 dhe 23 të jetës së tij.
4. Kompenzimi paguhet deri në vitin e 23 të jetës së lojtarit, për atë trajnim i cili është bërë deri në vitin 21 të jetës përpos nëse është e pa kontestueshme se lojtari ka ndërprerë periudhën e trajnimit para vitit 21. Me këtë rast kompenzimi për trajnim paguhet deri në fund të sezonit garuës në të cilën lojtari ka mbushur 23 vjet por llogaritja e shumës së kompenzimit do të bazohet në vitet ndërmjet datëlindjës së tij të 12 dhe kohës kur lojtari me të vërtetë ka përfunduar trajnimin e tij.

#### Neni 79

Obligimi i pagimit të kompenzimit vazhdonin të qëndrojë, pa marrë parasysh se a është realizuar transferimi gjatë kohës së kontratës apo në fund të saj dhe ajo është e pavarur nga obligimi i pagimit të dëmshpërimit për shkëputjen e kontratës.

#### Neni 80

1. Lojtari për të cilin paguhet kompenzimi i trajnimit, konsiderohet vetëm ai lojtar i cili nënshkruan kontratë profesionale me klubin e ri.
2. Statusi i klubit me të cilin lojtari kalon, përcaktohet në bazë të nivelit të garimit në të cilin klubi do të garoj në sezonin vijues garuës, ndërsa statusi i klubit nga i cili lojtari largohet, përcaktohet në bazë të nivelit të garimit në të cilin klubi ka garuar në sezonin e kaluar garues.

#### Neni 81

Kur lojtari nënshkruan kontratat e ardhshme profesionale, kompenzimi i paguhet klubit të fundit të tij.

#### Neni 82

Kompenzimi nuk paguhet në këto dy raste :



- a) Nëse ish klubi ka shkëputur kontratën pa shkaqe të arësyeshme (pa prejudikim për të drejtat e klubeve paraprake) ose
- b) Nëse lojtari profesionist pas transferimit fiton prapë statusin e amatorit.

#### Neni 83

1. Lartësia e kompenzimit përcaktohet me marrëveshje të shkruar të klubeve të interesuara.
2. Marrëveshja vërtetohet te organi regjistruar kompetent, të cilit i përket klubi nga i cili lojtari largohet.
3. Marrëveshja përpilohet në 5 kopje.

#### Neni 84

Nëse klubet e interesuara nuk kanë përpiluar marrëveshje të shkruar mbi lartësinë e kompenzimit, ajo përcaktohet me mënyren e paraparë me këtë Rregullore.

#### Neni 85

Kriteret për përcaktimin e kompenzimit janë :

- Moshë e lojtarit, koha në të cilën lojtari ka kaluar në klubin nga i cili largohet, statusi i lojtarit në klubin nga i cili largohet,
- A është klubi nga i cili lojtari largohet klubi amë i lojtarit, dhe
- A ka luajtur në ndeshjet zyrtare lojtari për përfaqësuesin A në dy vitet e fundit,

#### Neni 86

Për të njësuar shumën e kompenzimit, Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, përcakton shumën fikse për kompenzimin për trajnim dhe zhvillim për lojtarët nga moshë 14 deri 18 vjeç, shumën 1000 Euro për vitin që lojtari ka kaluar në klubin në fjalë, duke respektuar kushtet tjera të parapara me këtë Rregullore.

Në këtë rast, klubi i cili kërkon nga klubi tjetër i interesuar kompenzim për lojtarin e vet por marrëveshja dështon, e lojtari ka moshën mbi 16 vjeç, atëherë klubi është i obliguar që t'i ofrojë lojtarit kontratë profesionale së paku 10 ditë para përfundimit të afatit kalimtar, përndryshe lojtari ka të drejtë që të largohet si i lirë.

Këto rregulla vlejné vetëm për transferet vendore, ndërsa për ato ndërkombëtare vlejné rregullat nga Rregullorja për statusin e lojtarit e FIFA-s.

#### Neni 87

1. Klubi nga i cili lojtari largohet për çdo muaj të cilin lojtari e ka kaluar në statusin përkatës, ka të drejtë në kompenzimin e caktuar.
2. Mosha e lojtarit në kuptimin e kësaj Rregulloreje përcaktohet ashtu që konsiderohet se lojtari i ka aq vjet sa do ti mbushë në vitin kalendarik në të cilin i është bashkangjitur klubit tjetër.

#### Neni 88

1. Shuma e kompenzimit nga neni i mëparshëm rritet për :
  - 20 % - nëse klubi nga i cili lojtari largohet është klubi i tij amë,
  - 30 % - nëse lojtari është paraqitur në ndeshjet zyrtare të përfaqësueses A të Kosovës në dy vitet e fundit.
2. Klubi amë i lojtarit nënkupton klubin në të cilin lojtari është regjistruar për herë të parë dhe ka kaluar në të së paku 12 muaj apo 1 sezon garues.
3. Ndeshjet zyrtare e Përfaqësueses A konsiderohet ndeshja në mes të Përfaqësueses A të lojtarit dhe Përfaqësueses A të Federatës tjetër Nacionale.

#### Neni 89

1. Klubi nga i cili lojtari largohet ka të drejtë në kompenzim për periudhën e përgjithshme kohore në të cilat lojtari i ka kaluar pa ndërprerë nga viti i tij i 12 jetësor.
2. Në këtë periudhë llogaritet edhe koha gjatë së cilës lojtari ka qenë i huazuar klubit tjetër.

#### Neni 90

Nëse lojtari në dy vitet e fundit ka qenë anëtar edhe i klubit tjetër, i cili me rastin e kalimit të tij nuk ka pasur të drejtë në kompenzim, të drejtë në kompenzim nga klubi i tillë në të cilën lojtari kalon, ka edhe ai klub në lartësinë e përcaktuar në bazë me këtë Rregullore .

#### Neni 91

1. Klubi në të cilin lojtari regjistrohet si profesionist për herë të parë, është përgjegjës për pagesën e kompenzimit në afat prej 30 ditësh nga data e regjistrimit, secilit klub për të cilin ai lojtar ka qenë i regjistruar (sipas historisë së karrierës së lojtarit siç paraqitet në pasaportin e lojtarit) dhe i ka kontribuar trajnimit të tij duke filluar nga sezoni garues në të cilën lojtari i ka mbushur 12 vjet.
2. Shuma për pagimin e kompenzimit përlllogaritet në bazë proporcionale varësisht nga periudha e trajnimit në të cilin lojtari i ka kaluar në çdo klub.
3. Nëse nuk mund të përcaktohet lidhja mes lojtarit profesional dhe cilitdo klub që e ka trajnuar, ose nëse ato klube nuk lajmrohen në afat prej 18 muajsh nga dita e regjistrimit të parë si profesionist, kompenzimi i paguhet FFK-së në bazë të klubit ku lojtari profesionist është trajnuar. Ky kompenzim i dedikohet programeve të zhvillimit të futbollit të të rinjëve në FFK.
4. Kompenzimin në bazë të pikës së mëparshme të këtij neni FFK-ja të drejtë ta kërkojë në afat prej 6 muajsh pas kalimit të afatit 18 mujor nga dita e parë e regjistrimit të lojtarit si profesionist.

#### Neni 92

Mospërbushja e obligimit për pagesën e kompenzimit nuk ndikon në të drejtën e lojtarit për t'iu bashkangjitur klubit tjetër dhe të regjistrohet për të.

#### Neni 93

1. Kontestet lidhur me pagesën e kompenzimit në shkallë të parë i zgjidh KRSL.
2. Në vendimin e KRSL mund të paraqitet ankesa Komisionit për ankesa të FFK-së në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Vendimi i komisionit për ankesa i FFK-së mund të apelohe në DHNZK në afat prej 15 ditësh nga marrja e vendimit.
3. Mospagesa e kompenzimit sipas vendimit përfundimtar, konsiderohet kundërvajtje në bazë të dispozitave në bazë të Rregullores Disciplinore të FFK-së.

#### Neni 94

KE i FFK-së sjellë udhëzime dhe jep interpretime për aplikimin e dispozitave që kanë të bëjnë me kompenzimin.

### **Mekanizmi i solidaritetit**

#### Neni 95

1. Kur një lojtar, profesionist para se të i skadojë kontrata, lidh kontratë për transferim në tjetër klub në bazë të marrëveshjes së këtyre klubeve, klubi aktual ka të drejtë në dëmshpërblim lartësinë e së cilës e përcaktojnë klubet me marrëveshje. Pjesën (5%) nga dëmshpërblimi, përpos kompenzimit për trajnim dhe zhvillim të lojtarit, do t'i ndahet klubit apo klubeve të cilat kanë marrë pjesë në trajnimin dhe zhvillimin e lojtarit (mekanizmi i solidaritetit).
2. Kontributi i solidaritetit llogaritet në bazë të viteve (proporcionalisht të llogaritura nëse bëhet fjalë për periudhën më të shkurter se një vjet), gjatë së cilës lojtari ishte i regjistruar për klubet përkatëse në periudhën prej moshës 12 deri 23 vjeqare, dhe atë në këtë mënyrë:

Sezoni Garues	Lartësia e kompenzimit	
	Kompenzimi solidar në vite	Shuma e përgjithshme e kompenzimit
Në të cilën lojtari ka mbushur 12,13,14 ose 15 vjet	5 %	0.25 %
Në të cilën lojtari ka mbushur 16,17,18,19,20,21, 22 apo 23 vjet	10 %	0.5 %

3. Klubi i ri është i obliguar që kontributin solidar ti ja paguaj klubit /klubeve në bazë të dispozitave paraprake, së paku 30 ditë nga dita e regjistrimit të lojtarëve.
4. Klubi i ri obligohet që të llogarisë shumën e kontributit solidar dhe të ndajë atë në bazë të të dhënave të historisë së karrierës së lojtarit të shënuara në pasaportin e lojtarit. Nëse është e nevojshme lojtari do t'i ndihmoj klubit të ri të përmbushë këtë obligim.
5. Nëse në afat prej 18 muajsh nga regjistrimi i lojtarit nuk mund të përcaktohet lidhja ndërmjet lojtarit profesionist dhe klubeve në të cilat është trajnu apo nëse klubet nuk lajmrohen brenda 18 muajsh nga dita e regjistrimit të lojtarit, kontributi solidar

i paguhet FFK-së. Kontributi solidar i dedikohet programeve zhvillimore për futbollin e të rinjëve në FFK.

6. FFK-ja mund të kërkojë kontributin solidar në afat prej 6 muajsh pas kalimit të afatit 18 mujor nga dita e regjistrimit të lojtarëve.

#### Neni 96

1. Kontestet lidhur me pagesën e kontributit solidar në shkallë të parë e zgjidhë KRSL.
2. Ndaj vendimit të Komisionit për status pala e pakënaqur mund të parashtoj ankesë Komisionit për ankesa të FFK-së brenda 8 ditësh nga dita e marrjes së vendimit. Vendimi i komisionit për Ankesa i FFK-së është përfundimtar.
3. Si instancë e fundit është DHNZK që vepron si trup arbitrar. Ankesa duhet të bëhet brenda afatit 15 ditësh.
4. Mospagimi i kontributit të solidaritetit pas vendimit përfundimtar konsiderohet kundërvajtje në bazë të Rregullores Disciplinore të FFK-së.

### **X. DISPOZITAT PËR FUTBOLLIN E VOGËL**

#### Neni 97

Nëse me këtë Rregullore dhe Rregullorën për statusin e lojtarëve të FIFA-së nuk është përcaktuar ndryshe për disa marrëdhënje, dispozitat e kësaj Rregulloreje aplikohen në klubet dhe lojtarët për futboll të vogël.

#### Neni 98

Lojtari në futbollin e vogël është parimisht amator, i cili nuk paguhet për aktivitetin e tij në futboll më shumë se sa janë shpenzimet e investuara për të.

#### Neni 99

Për lojtarët e futbollit të vogël nuk aplikohen dispozitat e kësaj Rregulloreje të cilat kanë të bëjnë me periudhat e regjistrimit, në kompensimin për trajnim dhe zhvillim, si dhe në të drejtën në kontributin solidar.

#### Neni 100

Lojtari i regjistruar për futboll të madh nuk mund të regjistrohet për futboll të vogël.

## **XI. JURISDIKSIONI**

### **Kompetenca e FIFA-s**

Neni 101

- a. Pa prejudikuar të drejten e çdo lojtari apo klubi për të iu drejtuar një gjykatë civile për konteste të lidhura me punësim, FIFA është kompetente të bëjë dëgjimin për:
  - a) Kontestet (konfliktet) në mes klubeve dhe lojtarëve në lidhje me qëndrueshmërinë e stabilitetit kontraktual kur ka pasur një kërkesë për ITC dhe ankesë nga pala e interesuar në lidhje me kërkesen e përmendur për ITC, në veçanti lidhet me lëshimin e ITC, sanksioneve sportive apo kompenzimin për prishjen e kontratës;
- b. Kontestet e lidhura me punësim në mes klubit dhe lojtarit me dimension ndërkombëtar, përderisa një tribunal i pavarur arbitrimi garanton procedim të drejtë dhe respekton principet e përfaqësimit të barabartë të lojtarëve dhe klubeve, është etabluar në nivel nacional brenda kornizave të Asociacionit apo marrëveshjes kolektive të punësimit;
- c. Kontestet e lidhura me punësim në mes klubit, Asociacionit dhe trajnerit të një dimension ndërkombëtar, përderisa një tribunal i pavarur arbitrazhi garanton procedim të drejtë, i cili ekziston në nivel nacional;
- d. Kontestet lidhur me kompenzimin për trajnim dhe mekanizmin e solidaritetit në mes klubeve që u përkasin Asociacioneve të ndryshme;
- e. Kontestet lidhur me mekanizmin e solidaritetit ndërmjet klubeve që i takojnë federatës së njëjtë me kusht që transferi i lojtarit si bazë e kontestit paraqitet mes klubeve që i takojnë federatave të ndryshme;
- f. Kontestet në mes klubeve që i takojnë federatave të ndryshme e që nuk hyn në çështjet e parapara si në pikat a),d) dhe e).

### **Komisioni për statusin e lojtarëve**

Neni 102

1. Komisioni për statusin e lojtarëve duhet të gjykojë në çdo rast të përshkruar në nenin 101 pika c) dhe e) si dhe në të gjitha kontestet që dalin nga aplikimi i kësaj Rregulloreje, subjekt i nenit 103.
2. Në raste të paqartësisë së jurisdikcionit të komisionit për statusin e lojtarëve apo dhomës së zgjidhjes së kontesteve, kryesuesi i komisionit për statusin e lojtarëve do të vendos se cili trup ka jurisdikcionin.
3. Komisioni për statusin e lojtarëve do të gjykojë nën prezencën e së paku 3 anëtarëve përfshirë kryesusin ose zëvendës kryesuesin, përpos nëse çështja është e asaj natyre që mund të zgjidhet nga një gjyqtar i vetëm. Në rastet me urgjencë apo që ngritin çështje të vështira faktike apo legale, dhe për vendimet për lëshimin e ITC të përkohëshme në pajtim me aneksin, kryesuesi apo personi i caktuar nga ai, i cili duhet të jetë anëtar i komisionit, mund të gjykojë si gjyqtar i vetëm. Secila palë duhet të dëgjohej një herë gjatë procesit. Vendimet e arritura nga një gjyqtar i vetëm apo nga komisioni për statusin e lojtarëve mund të apelohej para Gjykatës së Arbitrazhit për Sport (CAS).

### **Dhoma e zgjidhjes së kontesteve e FIFA-s (DHZK)**

#### Neni 103

1. DHZK gjykon në të gjitha rastet e përshkruara me nenin 101 me përjashtim të kontesteve që kanë të bëjnë me lëshimin e një ITC.
2. DHZK do të gjykojë në prezencën e së paku tre anëtarëve, përfshirë kryesusin apo zëvendësin e tij, përpos nëse rasti është i asaj natyre që mund të zgjidhet nga gjykatësi i DHZK-së. Anëtarët e DHZK-së duhet të përcaktojnë një gjykatës për klube dhe një për lojtarët ndërmjet të gjithë anëtarëve e saj. Gjyqtari i DHZK mund të gjykojë në këto raste:
  - Të gjitha kontestet mbi vlerën e gjykuar të 100 mijë CHF,
  - Kontestet lidhur me kalkulimin e kompensimit për trajnim,
  - Kontestet lidhur me kalkulimin e kontributit të solidaritetit.

Gjykatësi i DHKZ është i obliguar ti referojë dhomës, për rastet që kanë të bëjnë me çështje fundamentale. Dhoma duhet të përbëhet nga numër i barabartë i përfaqësuesve të klubit dhe lojtarit, përpos në rastet kur çështja mund të gjykohet nga një gjyqtar i vetëm i DHKZ. Çdo palë duhet të dëgjohej një herë gjatë procedurës.

Vendimet e marra nga DHKZ apo gjyqtari i DHKZ mund të apelohe në Gjykatën e Arbitrazhit për Sport (CAS).

### **Dhoma Nacionale e Zgjidhjes së Kontesteve (DHNZK)**

#### Neni 104

DHNZK është kompetente të zgjidhë kontestet në mes klubeve dhe lojtarëve lidhur me punësimin dhe stabilitetin kontraktual si dhe të atyre që kanë të bëjnë me kompenzimin për trajnim dhe kontributin e solidaritetit në mes klubeve që i takojnë të njëjtit Asociacion. Jurisdikcioni, përbërja , Ligji i aplikueshëm dhe çështjet tjera janë lëndë e Rregullores së DHNZK të miratuar nga Komiteti Ekzekutiv i FFK-së.

### **XII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

#### Neni 105

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje pushon së vepruari Rregullorja për regjistrimin e klubeve, lojtarëve, dhe Rregullorja për statusin e lojtarit e nxjerr më 05.08.2009.

#### Neni 106

Kontestet të cilat kanë filluar dhe nuk kanë përfunduar para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje do të zgjidhen në bazë të dispozitave të Rregullorës së kaluar për regjistrimin, transferin dhe statusin e lojtarit.

#### Neni 107

Kontratat e lidhura para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje janë valide.

#### Neni 108

1. Interpretimin e kësaj Rregulloreje dhe dhënjen e udhëzimeve për aplikimin e saj, e bënë KE i FFK-së.
2. Në rast të mosharmonizimit të kësaj Rregulloreje me Rregulloren e FIFA-së për statusin dhe transferin e lojtarëve, aplikohen dispozitat e Rregullorës së FIFA-së për statusin dhe transferin e lojtarëve.

#### Neni 109



Çështja e cila nuk është e rregulluar me këtë Rregullore, zgjidhet me vendimet e KE të FFK-së në harmoni me Statutin e FFK-së dhe aktet përkatëse normative të FIFA-së.

#### Neni 110

Gjatë interpretimit të kësaj Rregullorëje duhet të nisemi nga këto parime:

1. Se kontratat duhet të respektohen,
2. Se kontratat mund të shkëputen në rast të shkaqeve të arësyeshme dhe shkaqeve të arësyeshme sportive, pa pasoja të karakterit disiplinor, me mundësinë e pagesës së kompenzimit dhe dëmshpërblimit në bazë të kësaj Rregullorëje duke respektuar principin e dhënjes së barabartë,
3. Se kontratat nuk mund të shkëputen gjatë sezonit,
4. Se te shkëputja e njëanshme e kontratës, pasojat e dëmshme i bartë pala e cila e ka shkëputur kontratën,
5. Se kompenzimi i obliguar për trajnim dhe zhvillim të lojtarit paguhet deri sa lojtari nuk mbush 23 vjet,
6. Se arësyeshmerinë e shkëputjes së kontratës e vlerëson organi kompetent i FFK-së nëse lojtari dhe klubi nuk mund të mirren vesh,
7. Se dispozitat e kësaj Rregullorëje mund ti ndryshojë vetëm KE i FFK-së.

#### Neni 111

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e publikimit të saj në fletën zyrtare të FFK-së.

Agim Ademi  
President i FFK-së